



Republika e Kosovës – Republika Kosova
Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtresa
Izborni Panel za Žalbe i Predstavke

A nr. 463/2013

Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtresa (PZAP), në panelin e përbërë nga gjyqtarët: Xhevdet Abazi kryesues, Ymer Hoxha dhe Nehat Idrizi anëtarë, duke vendosur përkitazi me ankesën e Partisë Demokratike të Kosovës (PDK) dega në Ferizaj, paraqitur kundër subjektit politik Lëvizja Vetëvendosja (LVV) dega në Ferizaj, për shkak të parregullsive gjatë procesit zgjedhor, vendosjes së posterit më afër se 100m nga Qendra e Votimit (QV), në seancën e panelit të mbajtur me 06.11.2013, mori këtë:

VENDIM

Refuzohet si e pabazuar ankesa e Partisë Demokratike të Kosovës (PDK) dega në Ferizaj.

Arsyetim

PZAP-i, ka pranuar një ankesë më datë 03.11.2013, nga subjekti politik PDK dega në Ferizaj, në të cilën theksohet se me datën 03.11.2013, në ora 10:00, në ditën e zgjedhjeve subjekti politik LVV kanë lënë të vendosur posterin e kandidatit të tyre për kryetar komune Faton Topalli afër qendrës së votimit të shkollës së mesme “Zenel Hajdini”, rr. “Brahim Ademi”, nën distancën e lejuar me të cilin veprim kanë bërë shkelje të dispozitës ligjore që sanksionohen nga rregulla ligjore nr.13/2013, Fushata e zgjedhjen dhe njoftimit për ngjarjet politike, e sanksionuar me nenin 8.3, si dhe ligjin mbi zgjedhjet e përgjithshme të Republikës së Kosovës.

PZAP-i, pasi që shqyrtoj ankesën gjeti se:

Ankesa është e pabazuar

Nga dëshmit e ofruara si provë të cilat gjenden në shkresat e lëndës nuk ka prova të mjaftueshme që do t'i bënim të besueshëm pretendimet ankimore të ankuesit të PDK ndaj subjektit politik LVV. Andaj PZAP-i, i vlerëson si të pabaza dhe të pa argumentuara duke u bazuar në dispozitat ligjore të nenit 3.6 pika c) Rregullave dhe Procedurave të PZAP-it, dhe në mbështetje të nenit 118 paragrafi 1 të LZP-së, lidhur me ankesën e lart përmendur u vendos si në dispozitiv të këtij vendimi.

Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtrësia

Anr. 463/2013 më datën 06.11.2013

**Kryesuesi i Panelit
Xhevdet Abazi**



Këshillë Juridik:

PZAP nuk do t'i pranojë kërkesat për ri-apelim, sepse vendimet e tij do të konsiderohen si përfundimtare. Prandaj, siç parashihet në Nenin 118.4 të LZP-së, *ankesa në Gjykatën Supreme të Kosovës mund të paraqitet brenda njëzetekatër (24) orëve nga momenti i marrjes së vendimit nga PZAP-i.*